


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP
Republika e Kosovës
Prishtinë



Lëvizja VETËVENDOSJE! Rr., Kasëm Haxhi Murati, Prishtinë

Përfaqësuar nga Blerim Sallahu

Lëvizja VETËVENDOSJE! pas pranimit të Vendimit nr. ~~233/2019~~ ^{287/2019}, me datë 17/10/2019, në ora 13 :00, si dhe në bazë të nënit 118 par.4, të LZP-së, PZAP –së, i paraqet këtë:

Rishikimi i Vendimit.

Anr.287/2019

Me datë 17 tetor 2019, konkretisht në orën 13:00, kemi pranuar, Vendimin, nr. Anr.287/2019, me të cilën dënohet subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me 500 euro, gjobë për shkak se kandidati për deputet nga radhët e LVV-së, Taulant Kryeziu, ka vazhduar sponsorizimin e fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilën shumë, subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcenim të përmbarimit.

Çështja e parë e cila duhet të kontestohet në këtë vendim është se ka një mospërputhje në mes të dispozitivit dhe arsytimit të këtij vendimi. Në dispozitiv thuhet se “Taulant Kryeziu kandidat për deputet nga radhët e LVV-së, ka lejuar vazhdimin e sponsorizimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “facebook”, ndërsa në arsytimin e këtij vendimi thuhet se LDK pretendon se “kandidati nga radhët e LVV, Taulant Kryeziu përmes INSTAGRAMIT, të tij, ka bërë thirrje për të votuar”. Më pastaj, PZAP, argumenton pretendimet e LDK –së për thyerje të heshtjes zgjedhore nga ana e kandidatit për deputet Taulant Kryeziu.

Çështja e dytë e cila është mjaftë e rëndësishme ka të bëjë me faktin se Vendimi Anr 287/2019 është nxjerrë nga PZAP, me datë 6 tetor 2019, ndërsa është dorëzuar sot me datë 17 tetor 2019, në orën 13:00.

Në lidhje me këtë, në nënin 8 par.8 pika 10 të Rregullës nr 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” të PZAP-së theksohet se “Vendimet e PZAP-it lidhur me ankesat duhet të përpilohen me shkrim të përmbajnë dispozitiv të qartë, dhe arsytim për gjendjen faktike të vërtetuar si dhe dispozitat përkatëse për aplikim e të drejtës procedurale dhe materiale, të cilat vendime duhet të ju dërgohen palëve në afatet e përcaktuara në nënin 118.2 të LZP-së” Në konkretizim të kësaj neni 118 par. 2 i LZP- së, thekson se “KZAP-i ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. KZAP-i u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej dy (2) ditëve nga momenti i lëshimit të vendimit, në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve të punës”.

Në lidhje me këtë, Vendimi i PZAP-së, Anr 287/2019 është kundërthënës në mes dispozitivit dhe arsytimit, si dhe ky vendim është dorëzuar Lëvizjes Vetëvendosje me datë 17 tetor 2019, në kundërshtim me afatin e paraparë me nenin 118 par.2, të LZP-së, i cili përcakton se “Për vendimet tjera KZAP-i ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve të punës” Pra, siç shihet Vendimi Anr.287/2019, i është dorëzuar LV, pas këtij afati ligjor, pra me datë 17 tetor, në orën 13:00. Andaj, pas argumentimeve të lartëcekura, kërkohet nga PZAP, që të rishikoj vendimin Anr.287/2019, dhe të marrë këtë:

V E N D I M

Anulohet Vendimi 287/2019, për faktin se dispozitivi dhe arsytimi i tij, është kundërthënës, si dhe ky vendim është dorëzuar LV, jashtë afatit ligjor të përcaktuar nenin 118 par.2 të LZP-sw

Vërejtje: Këtij rishikimi të vendimit do t'i bashkangjitet “Letra Përcjellëse” e cila konfirmon datën dhe orën e pranimit të këtij vendimi nga subjekti politik LV

Blerim Sallahu





Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë


Lënda: Letër përcjellëse;

Për: Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

Nga: Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

Datë: 06/10/2019.

Luteni të gjeni të bashkangjitur VENDIMIN e PZAP-it, *Anr. 287/2019*


(Emri dhe Mbiemri i pranuesit)

07.10.2019 / 13:00
Data dhe ora